



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 208, datë 11.10.2019

**PËR
CAKTIMIN E NJË GJYQTARI NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT PËR ETIKËN NË
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 83 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

VENDOSI:

1. Caktimin e znj. Albana Boksi, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa u shkëputur nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit.
2. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë dhe përfiton një trajtim financiar 5%, shtesë page, mbi pagën bruto fillestare të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR